



# DeckOil Color

## Ngjyra të ndryshme

IMPREGNIM ME VAJ



### Pamje e freskët me ngjyra dhe mbrojtje e sigurt kundrejt diellit dhe shiut

Vaj imprenjimin me ngjyrë për sipërfaqe prej druri në ambientet e jashtme. Nxjerr në pah natyrshmërinë e drurit dhe vendos thekse magjepsëse të ngjyrave. Lyeni me vaj dyshemetë e verandave dhe mobiliet e kopshtit – përfitoni nga mbrojtja efektive kundrejt çdo moti. Pigmentet e ngjyrave që gjenden në të i kundërvihen plakjes së drurit të kushtëzuar nga kushtet e motit dhe mundësojnë një paraqitje tërheqëse me ngjyra.

- Mbrojtje në thellësi kundrejt rrezatimit ultra-violet, ngricës dhe lagështirës
- Aftësi të mira depërtuese
- Përpunimi i shpejtë dhe i sigurt
- I përshtatshëm edhe për imprenjimin e mobilieve të kopshtit
- I përdorshëm te dërrasat e lëmuara dhe të valëzuara
- Përdorimi i mëparshëm i LOBA DeckPrepare përforcon jetëgjatësinë
- I përshtatshëm për lodra për fëmijë në përputhje EN 71-3

### Gama e përdorimit:

Të përshtatshme për deck druri, mobilje kopshti dhe objekte të tjera prej druri në ambientet e jashtme. I përshtatshëm për lodra fëmijësh, sipas kërkesave DIN EN 71-3 - "Migrimi i elementëve të caktuara". Rezistencë ndaj rrëshqitjes sipas grupit të vlerësimit B DIN 51097 dhe DIN EN 16165:2021-12 R10.

## Të dhëna teknike të produkteve

NR. ARTIKULLI			
10616	2,5l	4	120

<b>Solide</b>	46 ±2%
<b>Përbërësit</b>	hidrokarbure alifatike, vajra vegjetalë të modifikuar, pigmente ngjyruar, lëndë aktive anionike, ujë, substanca tharëse pa kobalt
<b>Magazinimi dhe transportimi</b>	36 muaj kohëzgjatja maksimale e magazinimit. Nuk ndikohet nga ngrica. Meterial i parrezikshëm sipas ADR.
<b>GISCODE</b>	Ö60

## Të dhëna teknike të produkteve

800145  
Kafe e hapur800150  
Kafe e errët800099  
E kuqe në kaf900148  
Gri

Pa garanci për ngjyrën

## Udhëzime përpunimi

- Kushti optimal i përpunimit në +15°C deri +25°C, lagështia relative e ajrit 40% deri 75%, temperatura e materialit +15°C deri +25°C.
- Mos e vendosni mbi pjesët e nxehta ose mbi sipërfaqet e ekspozuara kundrejt rrezeve të diellit, duke qenë se shtresa e vendosur mund të thahet shumë shpejt. Mos e vendosni, nëse brenda 3 orëve pas vendosjes pritët të bjerë shi.
- Nëse keni dyshimi, krijoni një sipërfaqe testimi për të përcaktuar përputhshmërinë, ngjitjen dhe optikën. Rezultatet mund të ndryshojnë në varësi të llojit të drurit, sidomos në rastin e llojeve të druve që përmbajnë vaj, me ngjyra intensive dhe rrëshirë.
- Tundni mirë materialin.
- Para aplikimit transferoni materialin në një kovë LOBATOOL.
- Mënjanoni formimin e bulëzave mbi sipërfaqe, ose sheshojeni menjëherë me penel ose furçë.
- Kini parasysh rregullat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë së punës për produktin. Me shumë informacion specifik në lidhje me GISCODE mund të gjendet tek udhëzimet e përdorimit, të disponueshme në [www.wingis-online.de](http://www.wingis-online.de).

### HOLLUES

Për të krijuar një nuancë më të hapur ose për të reduktuar aftësinë e mbulimit përzihet me variantin transparent. Max. 3 pjesë transparent dhe 1 pjesë ngjyrë.

### MJET APLIKIMI / NORMË APLIKIMI

Furçë vaji LOBATOOL, penel, leckë që nuk lëshon fije / leckë 80-120ml/m<sup>2</sup> për çdo aplikim.

Konsumi real i materialit varet nga lloji i drurit, lagështira e drurit dhe gjendja e vjetërimit të sipërfaqes, nëse nevojitet, konsumi real duhet të llogaritet nëpërmjet një aplikim provë. Imprenjimi/ efekti mbrojtës garantohet vetëm kur arrihet ngopja e fibrave (absorbimi maksimal i vajit nga ana e drurit). Për këtë mund të jenë të nevojshme disa aplikime.

### KOHA E THARJES

- rreth 12 orë.

### PREGATITJA:

- Nëse nevojitet, pastroni më parë mbetjet, myshkun apo shtresa të vjetra boje.
- Drurët e sapoinstaluar me pore të mbyllura shpesh nuk janë në gjendje të absorbojnë sasi të mjaftueshme vaji, prandaj më parë duhen hapur poret. Kjo mund të bëhet: Duke lënë drurin të ndikohet nga kushtet klimatike, ose lageni me ujë dhe lini të thahet disa herë.
- Sipërfaqet prej druri në ambientet e jashme të vjetra, të ndotura dhe të dëmtuara nga erozioni i pastroni me LOBA DeckDegrayer. Kini parasysh informacionet teknike të produktit.

### PREGATITJA:

- Aplikoni LOBA DeckOil me furçë ose me leckë pa push në mënyrë të njëtrajtshme dhe në të njëjtin drejtim me fibrat e drurit.
- Lini të veprojë për 30 min, pastaj hiqni plotësisht vajin e pa-absorbuar me furçë ose një leckë pa push.
- Në mobiljet prej druri, veçanërisht karriget fshijini pothuajse deri sa të thahen duke përdorur peshqir absorbues.
- Për sipërfaqe të mëdha përdorni furçë LOBATOOL.
- Nëse është e nevojshme pas tharjes për një natë bëni një aplikim akoma me vaj.

### INFORMACION I RËNDËSISHËM

Materialii tepërt duhet të hiqet plotësisht gjatë njëtrajtësimit të sipërfaqes. Tharja me vonesë është e mundshme në disa drurë ekzotikë.

Keep soaked cloths, pads and other tools in closed containers. Moisten oil in combination with sanding dust, fabric cloths and so on with water or store in a sealable bucket and dispose of in a fire-safe manner, since otherwise there is a risk of self-ignition.

## Udhëzime të përgjithshme

**Koha e tharjes:** Koha e tharjes e përmëndur është e vlefshme për temperaturë +20°C dhe lagështi relative të ajrit 50%, si dhe ajrosje të vazhdueshme të ambientit të punës, pa rryma ajri. Temperaturat më të ulta, lagështia relative e lartë, mosajrosja e duhur vonojnë tharjen. Pa arritur forcimin (tharjen) e plotë mos pastroni dhe mos shtroni tapete. Për mbulimin e sipërfaqes para tharjes së plotë përdorni LOBA Cover 400. Karakteristikat specifike të produktit gjenden në informacionet teknike përkatëse.

Informacioni në këtë material si dhe të gjitha këshillat dhe rekomandimet, të cilat ofrojmë në ndihmë dhe asistencë të përdoruesit, janë rezultat i përvojës së deritanishme dhe u referohen kushteve Speziale. Për shkak të mundësive të shumta të aplikimit dhe kushteve të përpunimit, nuk përjashtojmë nevojën e përdoruesit për të kryer testimet e veta ose të kërkojë këshilla teknike duke kontaktuar me Departamentin e aplikimit teknik LOBA. Respektoni standartet aktuale dhe rekomandimet e prodhuesit të produkteve për shtrimin-përpunimin e parketeve. Detyrimet dhe përgjegjësia janë përcaktuar ekskluzivisht nga Termat dhe Kushtet tona dhe nuk zgjerohen as përmes këtij informacioni as përmes këshillave tona. Publikimi i të dhënave më të reja teknike automatikisht zhvlerëson ato të mëparshme.

Fjalët dhe simbolet me shenjën ® përfaqësojnë të drejta tregu, të cilat janë të regjistruara dhe të mbrojtura të paktën për hapësirën e Gjermanisë.